



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**

**K.P.P.776/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “Vashtëmia” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr.REF-81484-07-31-2018 me objekt “Sistemim asfaltim rruga fshati Dolna Gorica (Faza I)”, me fond limit 5,916,658 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pustec.

**Ankimues:**

“Vashtëmia” shpk  
Vashtëmi, Korçë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Pustec  
Pustec, Korçë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 31.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-81484-07-31-2018 me objekt “Sistemim asfaltim rruga fshati Dolna Gorica (Faza I)”, me fond limit 5,916,658 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pustec.

II.2. Në datën 20.08.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.09.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Shamo Construction	pa ofertë	I skualifikuar
- Pegasus	pa ofertë	I skualifikuar
- Vashtëmia	3,424,965	I skualifikuar
- Artyka II	3,982,433	I kualifikuar
- Al Dok	4,580,130	I kualifikuar
- Sark	4,599,301	I kualifikuar
- Murati	4.715.425	I kualifikuar
- Shendelli	5,135,840	I kualifikuar
- Boshnjaku B	5,197,490	I kualifikuar

II.4. Në datën 10.09.2018 operatori ekonomik “Vashtëmia” sh.p.k njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Oferta e operatorit ekonomik rezulton anomalisht e ulet. Argumentimi dhe justifikimi i cmimit i bere nga operatori nuk eshte sipas VKM nr 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 66, pika 5. Operatori nuk ka paraqitur dokumentacion dhe prova shkresore per argumentimin e ofertes anomalisht te ulet.*

II.5. Në datën 14.09.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Refuzimi i ofertës nga ana e institucionit tuaj është totalisht i pasaktë dhe i pambështetur në legjislacion. Për argumentimin e ofertës sonë pranë zyrës së Bashkisë Pustec kemi dorëzuar dy përgjigje në sqarim të shkresës suaj Nr.472 prot datë 24.08.2018. Kemi përgatitur shkresat dhe kemi dorëzuar në protokollin tuaj shkresën tonë me Nr. 119/2018 prot datë 27.08.2018 po në datën 27.08.2018. Tek kjo shkresë kemi sqaruar në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së procesit të prodhimit , zgjidhjet teknike dhe kushtet që na favorizojnë për realizimin e kontratës. Kjo vërtetohet nga referencat e sakta nr.prot datë që i kemi bërë shkresë Bashkisë Pustec (shkresa bashkëngjitu ankesës 6 fletë).*
- *Në datën 31.08.2018 na është dorëzuar nga zyra postare Lumalas po e njëjta shkresë e Bashkisë Pustec të cilës i jemi përgjigjur po në rrugë shkresore brenda afatit të lejuar me shkresën nr. 119/1 prot datë 03.09.2018. Këtë shkresë e kemi dorëzuar pranë sekretarisë së Bashkisë Pustec të cilët e kanë pranuar me nr.472/2 prot datë 03.09.2018. (bashkëngjitur kësaj ankese shkresa 7 fletë). Tek kjo shkresë kemi sqaruar në mënyrë të detajuar anën*

*ekonomike të metodës së procesit të prodhimit , zgjidhjet teknike dhe kushtet që na favorizojnë për realizimin e kontratës.*

- *Në mbështetje të sa kemi argumentuar më lart për përgjigjet e dërguara shkresërisht ju sqarojmë se të tilla formate kemi dërguar me sukses pranë autoriteteve të tjera kontraktore.*

II.6. Në datën 18.09.2018 me shkresën nr. 523 prot operatori ekonomik ankimues “Vashtëmia” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 21.09.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 562/1 prot datë 03.10.2018 protokolluar me tonën me nr.1520/2 datë 05.10.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vashtëmia” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Oferta e operatorit ekonomik rezulton anomalisht e ulët. Argumentimi dhe justifikimi i cmimit i bere nga operatori nuk eshte sipas VKM nr 914,datë 29.12.2014,i ndryshuar,neni 66, pika 5. Operatori nuk ka paraqitur dokumentacion dhe prova shkresore per argumentimin e ofertes anomalisht te ulët”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr. 562/1 prot datë 03.10.2018 protokolluar me tonën me nr.1520/2 datë 05.10.2018 me objekt “Dërgohet informacioni” rezulton se me shkresën nr.472 prot datë 24.08.2018 autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Vashtëmia” shpk kërkesë për shpjegime mbi ofertën anomalisht të ulët me përmbajtje si më poshtë:

- *Oferta juaj në vlerën 3,424,965 rezulton anomalisht e ulët. Ju lutemi jepni argumentet tuaja (brenda tre ditësh) për zërat e mëposhtëm :*

1. Anën ekonomike të metodës së procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara nga shoqëria juaj.
2. Zgjidhjet teknike të ofruara apo kushte favorizuese që ka shoqëria juaj për furnizimin e mallrave apo shërbimeve
3. Originalitetin e mallrave apo shërbimeve të propozuara nga shoqëria juaj.

Konkretisht për zërat:

Nr. An	Emërtimi i Punimeve
3.212	Shtresë cakulli makadam t=15 cm për bankina
3.222/1	Shtresë binderi t=5cm
3.226/1	Shtresë asfaltbetoni t=4cm
3 An/It	FV tubo të brinjëzuara HDPE SN 8 d=315 mm
3.222/1	FV tubo celiku t=5 mm fi 300, 400 mm.

III.1.2. Me datë 27.08.2018 me shkresën nr.119/2018 prot operatori ekonomik “Vashtëmia” i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij me përmbajtje si vijon:

- Në përgjigje të shkresës suaj nr. 472 prot datë 24.08.2018 ju bëjmë me dije se: Oferta jonë bazohet tek kapacitetet dhe mundëistë tona qe janë si më poshtë:
- Eksperiencë 25 vjecare e personelit inxhiniero teknik dhe punonjësve të specializuar për punime në ndërtim rrugësh, sigurojnë rendiment të lartë dhe kosto të ulët punimesh.
- Mekineritë e kërkuara për realizimin e këtij objekti janë në pronësi të subjektit tonë . Të tilla janë Fabrikë Asfaltbetoni me kapacitet 60 ton /orë. Gurorja dhe linja e prodhimit të inerteve. Pronësia nga sa më sipër na siguron kosto të ulëta prodhimi në materialet që do të përdoren në objektin e tenderit.
- Të gjitha mjetet e transportit të materialeve dhe pjesa më e madhe e mjeteve për shtrimin e asfaltit, rrulat janë në pronësi të subjektit dhe garantojnë kosto të ulët të proceseve që ato realizojnë.
- Me cmimet e dhëna në preventivin e këtij objekti sipas sqarimeve bashkëngjitur ne kemi realizuar edhe objekte të tjera gjatë viteve të fundit.
- Nga sa më sipër ne ju garantojmë realizimin e objektit në kohë e cilësi si dhe me cmimin sipas ofertës sonë. Ju lutem gjeni në vijim Analizat e Cmimeve për zërat e preventivit.

*Analiza Cmimi për zërat Shtresë cakulli makadam t=15 cm për bankina, Shtresë binderi t=5cm, Shtresë asfaltobetoni t=4cm, FV tubo të brinjëzuara HDPE SN 8 d=315 mm, FV tubo celiku t=5 mm fi 300, 400 mm. (5 fletë).*

III.1.3. Gjithashtu në informacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet se në datën 03.09.2018 me shkresën nr.110/1/2018 prot operatori ekonomik “Vashtëmia” shpk ka ridërguar sqarime mbi ofertën anomalisht të ulët nga ku rezulton se janë paraqitur analizat e cmimeve për zërat *Shtresë cakulli makadam t=15 cm për bankina, Shtresë binderi t=5cm, Shtresë asfaltobetoni t=4cm, FV tubo të brinjëzuara HDPE SN 8 d=315 mm, FV tubo celiku t=5 mm fi 300, 400 mm* ku rezulton se në faqen 3 të shkresës është bërë një shënim citojmë: referuar faturës së fundit të importit Nr.1564 datë 18.05.2018 me importues Konti Hidroplast Maqedoni Cmimi i Blerjes të produktit Tubo të brinjëzuar HDPE SN8 D=315 mm është 685 lek/ml. Në rast se i referohemi vlerës së ofruar në preventivin përkatës kemi një normë tepër të justifikueshme fitimi për realizimin e këtij zëri. Akoma më tej në faqen 4 është bërë shënimi : Referuar ofertave në treg nga prodhues të produktit Tubo Celiku t=5 cm fi 300, 400 mm rezulton që cmimi i këtij produkti është maksimalisht 45 lek/kg. Në rast se i referohemi vlerës së ofertuar në preventivin përkatës kemi një normë tepër të justifikueshme fitimi për realizimin e këtij zëri. Në këtë shkresë ripërsëriten gjithashtu edhe argumentimet e sipërcituara lidhur me makineritë, eksperiencën , puntorinë, etj.

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë

*oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.1.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të

ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Vashtëmia” sh.p.k në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 27.08.2018 nga operatori ekonomik “Vashtëmia” shpk rezulton se është deklaruar se *“Mekineritë e kërkuara për realizimin e këtij objekti janë në pronësi të subjektit tonë. Të tilla janë Fabrikë Asfaltbetoni me kapacitet 60 ton /orë. Gurorja dhe linja e prodhimit të inerteve. Pronësia nga sa më sipër na siguron kosto të ulëta prodhimi në materialet që do të përdoren në objektin e tenderit,* ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion (marrëveshje, kontratë, faturë tatimore) për të vërtetuar këtë fakt.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se shoqëria “Vashtëmia”, përveç argumentimit të vet në formën e një deklarate, si dhe analizës së koston për zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktuar nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar, pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e objektit të kontratës pranë autoritetit kontraktor. Paraqitja e deklaratës në formën e një CV-je lidhur me eksperiencën, stafin, makineritë e pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri



## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vashtëmia” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr.REF-81484-07-31-2018 me objekt “*Sistemim asfaltim rruga fshati Dolna Gorica (Faza I)*”, me fond limit 5,916,658 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pustec.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1520 Protokoli, Datë 21.09.2018**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

